



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.187 dt.24.12.1998

**MBI SHQYRTIMIN E ANKESAVE PER DHENIE TE LEJEVE TE  
NDERTIMIT NGA K.RR.T.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.24.12.1998, pasi shqyrtoi ankesat e disa qytetarëve, duke u mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Pushtetit Lokal” si dhe në ligjin Nr.8015, dt.19.10.1995, neni.12 “Për disa ndryshime” në ligjin Nr.7693, dt.26.04.1993, “Për Urbanistikën” dhe pasi dëgjuan propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve.

**V E N D O S I**

1. Familja Madhi ankohet për bllokimin e dritës së studios së piktorit Guri Madhi nga një ndërtim i ri i Familjes Kraja. Komisioni i Zhvillimit Urban dhe i Ndërtimeve pasi dërgoi në vend një komision i propozoi Këshillit Bashkiak që të ulët lartësia e ndërtesës së Familjes Kraja për të ruajtur distancën 3 m, nga dyshemeja e studios së Guri Madhit deri në kulmin e ndërtimit të ri. Këshilli Bashkiak e miratoi propozimin e Komisionit.
2. Kërkesa e qytetarit Zabit Papoi për të rrethuar banesën e tij sipas kushteve që do të jepen nga Drejtoria e Urbanistikës, Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve, Këshilli Bashkiak miratoi kërkesën e Qytetarit Zabit Papai për të

rrethuar banesën e tij sipas kushteve që do të jepen nga Drejtoria e Urbanistikës.

3. Këshilli Bashkiak miratoi kërkesën e Valbona Tartarit për të shtuar një kat në banesën e saj.
4. Këshilli Bashkiak sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve, miratoi kërkesën për shtesë apartamentit të Z.Valter Bablusha pasi i interesuari paraqiti miratimin nga banorët e pallatit përkatës.
5. Këshilli Bashkiak vendosi që KRRT të dëgjojë ankesat e qytetarëve, Qerime Karapici dhe Fatime Mborja lidhur me disa çështje ndërtimesh në pronat e tyre.
6. Këshilli Bashkiak, sipas parashtrimit të Komisionit të Zhvillimit Urban dhe të Ndërtimeve e gjen çështjen e ngritur nga banorët e pallatit 25/1 në Rr.”Bajram Curri” problem pronësie, pra është jashtë kompetencave të këtij Këshilli.
7. Këshilli Bashkiak, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve vendosi që familjeve Nuri Ishmi t’i miratohet leja e ndërtimit në truallin e vet duke pasur ndërtim kallkan faqet, lindje dhe perëndim.
8. Këshilli Bashkiak miratoi propozimin e Komisionit të Urbanistikës dhe Strehimit të këtij Këshilli për të mos miratuar lejen e ndërtimit sipas kërkesës së Z.Muharrem Kushi, duke mos e quajtur të nevojshme pikën Nr.2 të Vendimit Nr.78, dt.20.02.1998 të KRRT.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**